



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.:	Nr. Prot:
Dep. DPK	Br. Prot. 03-02/1648/11
Dep. DPK	Prot. No. 03-02/1648/11
Nr. ifaq:	Data:
Broj stranica 02	Datum 13.06.2018
Nr. pages:	Date:
	13.06.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.06.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-499/18, për zyrtarin z. Amir Rexhepi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Ferizajt, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-03-02-499/18, që për trajtim ka pasur zyrtarin z. Amir Rexhepi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Ferizajt, janë ndërmarr veprime dhe është zhvilluar procedurat e paraparë për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.

Ky rast, ka filluar të shqyrtohet pas një informate anonime të dërguar në adresë të AKK-së, me pretendimet se z. Amir Rexhepi në kundërshtim me ligjin mban apo ushtron dy funksione si: Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Ferizajt dhe Drejtor në Shkollën "Dëshmorët e Koshares".

AKK-sipas procedurës ka analizuar informatën e dërguar dhe ka vërtetuar se z. Amir Rexhepi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Ferizajt, ushtron edhe pozitën e si u.d. Drejtor në shkollën fillore të mesme të ultë në fshatin Koshare të Komunës së Ferizajt.

Sipas procedurës së paraparë AKK me shkresë zyrtare e ka njoftuar zyrtarin e lartë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në



ushtrim të funksionit publik dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Amir Rexhepi, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe është interesuar për një takim me zyrtarët e AKK-së për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar.

Ky takim është organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin z. Amir Rexhepi, zyrtarët e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet dhe provat që posedon Agjencia lidhur me rastin e iniciuar, ndërsa zyrtari ka deklaruar, së ai është zgjedhur si Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Ferizajt, dhe është duke u ushtruar edhe pozitën si u.d. Drejtor ne shkollën fillore të mesme të ultë në fshatin Koshare të Komunës së Ferizajt, ku deri me tani nuk ka pas ndonjë kërkesë apo informatat se nuk mund të ushtrij këto dy pozita, mirëpo ka deklaruar se do të veproj sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe do ta njoftoj AKK-në, për veprimet e ndërmarra.

Agjencia Kundër Korrupsionit pas takimit me zyrtarin në fjalë ka pritur përgjigjen e zyrtarit z. Amir Regjepi, mirë po i njëjti nuk na ka njoftuar për asnjë veprim të ndërmarr, andaj jemi obliguar që ti dërgojmë edhe shkresën dytë njoftuese ku e kemi paralajmëruar se ushtrimi i një kohësishëm i pozitave si Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Ferizajt dhe u.d. Drejtor ne shkollën fillore të mesme të ultë është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe brenda afatit të paraparë duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për ta parandaluar këtë situatë në të kundërtën AKK-ë është e obliguar të veproj sipas dispozitave përkatës që rrjedhin nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pas këtij komunikimi nga z. Amir Rexhepi kemi pranuar njoftimin zyrtar se ka dhënë dorëheqje nga pozita e u.d. i Drejtorit në shkollën fillore të mesme të ultë në fshatin Koshare, Komuna e Ferizajt.

Po ashtu jemi njoftuar edhe nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj se është miratuar dorëheqja e paraqitur nga z. Amir Rexhepi si u.d. Drejtor ne shkollën fillore të mesme të ultë në fshatin Koshare Komuna e Ferizajt.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z. Amir Rexhepi, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Ferizajt, duke dhënë dorëheqje nga pozita e u.d. Drejtorit ne shkollën fillore të mesme të ultë në fshatin Koshare Komuna e Ferizajt, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit dhe kufizimit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

